



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 05 maj 2023

Kodi i ZRRE-së V_1739_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, Nenin 16, Nenin 25, Nenin 26, Nenin 28 par. 1 dhe 2, Nenin 30 par. 1, Nenin 55 par. 1, nënpar. 1.5, Nenin 56 par. 1 nënpar. 1.2, dhe Nenin 57 par. 2 nënpar. 2.2, 2.7, 2.8 dhe 2.14 lidhur me par. 3, par. 6, 7, 8 dhe 9 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 16 par. 1.22, Nenin 19 dhe 22 par. 2 dhe 3, Nenin 32 par. 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085;
- Dispozitat e Nenit 8 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike;
- Dispozitat e Nenit 2 par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut;
- Dispozitat e Nenit 2.5.1.1 të Kodit të Balancit;
- Dispozitat e Nenit 9 të Kontratës për Shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës;
- Dispozitat e Nenit 3, Nenin 4, Nenit 5, Nenin 7 dhe Nenin 8 dhe Nenin 9 par. 2 nënpar. 1.2, 1.7, 1.8 dhe 1.14 lidhur me par. 2, par. 4, 6, 7, 10, 12 dhe 13 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat;
- Dispozitat e Nenit 3, Nenit 28 dhe Nenit 37 të Licencës Nr. ZRRE/Tr_15/17 për Operatorin e Sistemit të Transmetimit për "KOSTT" SH.A.;
- Njoftimin e ZRRE-së, Nr. 111/23 të datës 24 shkurt 2023 lidhur me shkeljet e konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për "KOSTT" SH.A.; dhe
- Përgjigjet në Njoftim të pranuar me datë 13.03.2023 nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për "KOSTT" SH.A.,

në seancën e mbajtur me 05 maj 2023 ka nxjerr këtë:

V E N D I M

- I SHQIPTOHET - DENIMI ME GJOBË** Operatorit të Sistemit të Transmetimit për "KOSTT" SH.A., për shkak të shkeljeve ligjore të konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet në shumën prej 439,405.00 € (katërqind e tridhjetenëntëmijë e katërqindepesë Euro).
- DETYROHET** - Operatori i Sistemit të Transmetimit për "KOSTT" SH.A., që brenda periudhës 2 (dy) vjeçare në 4 (katër) kiste, të paguajë gjobën në llogarinë Nr. 1000 4300 7000 8375 në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në shumën e përcaktuar si në pikën I. të dispozitivit, nën pasojat e përmbartimit me detyrim.

A R S Y E T I M



Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në përputhje me kompetencat e dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ka bërë monitorimin në lidhje me blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet për Operatori i Sistemit të Transmetimit për (në tekstin e mëtejshëm: KOSTT SH.A.).

Monitorimi ishte fokusuar në mbledhjen, vlerësimin, analizimin dhe evidentimin e devijimeve nga parimet e ligjshmërisë, dhënien e opinionit të pajtueshmërisë lidhur me tregtimin e energjisë elektrike, dhe nëse aspektet materiale dhe procedurale janë kryer në përputhje ose jo me dispozitat ligjore në fuqi.

Qëllim ishte që të vërtetohen shkeljet eventuale në lidhje me evidentimin e devijimeve nga parimet e ligjshmërisë, mbi: a) Faturimin dhe Pagesat ndërmjet të Licencuarve; b) Blerjet e energjisë nga KOSTT për mbulim të humbjeve në rrjetin e transmetimit; c) Blerjet e energjisë nga KOSTT për mbulim të humbjeve në veri të vendit; d) Devijimet e sistemit në raport me rrjetin interkonektiv; e) Shfrytëzimi i rezervave rregulluese, dhe ë) Shfrytëzimi i Fondit për energjinë e ripërtrishme (FER).

ZRRE, në kuadër të monitorimit në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nominimet për Operatori i Sistemit të Transmetimit për "KOSTT" SH.A., ka përgatitur një Raport me të gjeturat të cilin ja ka prezantuar Bordit të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 16.11.2022, ka shqyrtuar të gjeturat në Raportin e përgatitur nga ekspertët e ZRRE-së, dhe më datë 16.11.2022, përmes dokumentit Raporti i Monitorimit në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nominimet për Operatori i Sistemit të Transmetimit për "KOSTT" SH.A., ka njoftuar palët lidhur me të gjeturat e Monitorimit.

Po ashtu, Bordi i ZRRE-së, bazuar në Nenin 7 par. 2 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat, ka kërkuar nga "KOSTT" SH.A. që në afat prej 15 ditë kalendarike të ofroj përgjigjet me shkrim lidhur me të gjeturat në Raport.

ZRRE me datë 02.12.2022 nga "KOSTT" SH.A, ka pranuar Komentet në Raportet e Monitorimit për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet Operatori i Sistemit të Transmetimit për "KOSTT" SH.A. të datës 16.11.2022, duke paraqitur përgjigjet në të gjeturat dhe konstatimet e evidentuara nga Raporti i Monitorimit të ZRRE-së.

ZRRE me datë 31.01.2023 i ka dërguar KOST SH.A., kërkesën për të ofruar sqarime lidhur me aktivizimin e MFRR, arsyet e refuzimit të ofrimit të shërbimit nga KESH si pas Ofertuese e Shërbimit, Kostot e devijimit për shkak të refuzimit të MFRR, si dhe Kostot e MFRR, të realizuara sipas dakordimeve mujore.

ZRRE ka vlerësuar komentet e dërguara nga "KOSTT" SH.A., lidhur me monitorimin e blerjeve të energjisë elektrike, pagesat dhe devijimet në nominimet e energjisë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për "KOSTT" SH.A.

ZRRE ka vlerësuar se, moszbatimi me kohë i dispozitave përmbartimore sipas kontratës mes palëve ka shkaktuar probleme financiare dhe ka rrezikuar stabilitetin financiar të KOSTT, e cila si kompani publike do duhej të reagoje me kohë.

ZRRE ka vlerësuar se, me mos zbatimin e garancionit financiar, KOSTT nuk është në pajtueshmëri me Rregullat e tregut Neni 8 dhe me Procedurën e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar.

ZRRE ka vlerësuar se KOSTT nuk ka ofruar argumente relevante për t'i kundërshtuar të gjeturat në Raportin e ZRRE-së, andaj "KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28, par.1 dhe par. 2 dhe



nenin 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, nenin 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, nenin 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, nenin 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike”.

ZRRE ka vlerësuar se KOSTT SH.A., tregtimin e energjisë elektrike mes KOSTT dhe KEK për energjinë e pa-faturuar për pjesën veriore të Kosovës paraqet shkelje të Ligjit për energjinë elektrike, neni 22, paragrafi 2 dhe 3, dhe konsideron se nuk janë relevante arsyetimet e dhëna nga KOSTT lidhur me tregtimin e energjisë elektrike me tregtarë të pa licencuar në Kosovë, apo me njohje reciproke sipas kërkesave ligjore.

ZRRE rithekson se KOSTT nuk ka ofruar argumente relevante për t'i kundërshtuar të gjeturat në Raportin e ZRRE-së, andaj “KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28, par.1 dhe par. 2 dhe nenin 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, nenin 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, nenin 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, nenin 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike”.

ZRRE ka vlerësuar se KOSTT ka bërë shkelje sepse nuk ka shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e paraparë me kodin e balancës, neni 2.5.1.1, për të parandaluar shfaqjen e mungesës së energjisë (masat e ndërmarra si importet, injektimet apo veprimet balancuese nuk mund të plotësojnë kërkesën totale), por ka kaluar direkt në mekanizmin e fundit duke urdhëruar KEDS-in që të aplikoj reduktim të ngarkesës në rrjetin e shpërndarjes.

Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2023 ka shqyrtuar përgjigjet/komentet e dërguara nga “KOSTT” SH.A., ndaj *Raporti i Monitorimit* në lidhje me blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet për operatorin e sistemit të transmetimit (KOSTT), dhe ka konstatuar se janë evidente shkeljet e konstatuara përmes raportit të Monitorimit, si dhe ka kërkuar sqarime shtesë, në lidhje me aktivizimin e mFRR dhe kostot e shkaktuara për periudhën monitoruese.

ZRRE me datë 31.01.2023 i ka dërguar KOSTT kërkesën për të ofruar sqarime lidhur me aktivizimin e mFRR, ku me datë 06.02.2023 dhe më datë 16.02.2023 ZRRE ka pranuar raportet sqaruese.

Në raportet e dërguara, KOSTT për periudhën e raportimit, ka paraqitur sasinë e kapacitetit të kërkuar për mFRR, arsyet e refuzimit të ofrimit të shërbimit nga KESH si Palë Ofruese e Shërbimit, Kostot e devijimit për shkak të refuzimit të mFRR, si dhe Kostot e mFRR_ të realizuara sipas dakordimeve mujore.

Bazuar në të dhënat e dërguara nga KOSTT për periudhën raportuese, në disa raste Pala Ofruese e Shërbimit (POSH) ka dështuar të siguroj energjinë e deklaruar për aktivizimin e mFRR, me ç'rast janë shkaktuar devijime ndaj sistemit interkonektiv. Sipas Kontratës për Shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës mes palëve KOSTT dhe KESH si POSH, respektivisht neni 9, *në rast se POSH i mFRR dështon të aktivizoj në tërësi ose pjesërisht kapacitetin e deklaruar paraprakisht dhe të kërkuar nga KOSTT, atëherë POSH i mFRR i nënshtrohet përgjegjësisë së mekanizmit balancues në zonën LFC ku ai operon.*

Ashtu siç edhe është paraqitur në raportet e KOSTT lidhur me aktivizimin e mFRR si dhe sipas deklarimeve në takimin e mbajtur më 30.01.2023, në disa raste KOSTT nuk ka zbatuar nenin 9 të kontratës mFRR duke marrë përsipër edhe kostot e devijimeve të shkaktuara nga mosrespektimi i aktivizimit të mFRR nga ana e POSH. Për më tepër, KOSTT ka aktivizuar mFRR edhe në rastet kur nuk ka qenë e nevojshme, por është aktivizuar për nevojat e balancimit të sistemit.



Rrjedhimisht vlen të theksohet se bazuar në Rregullën për vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale të OST dhe OT, në kuadër të të hyrave të lejuara ZRRE përcakton edhe Kostot e lejuara për shërbimet ndihmëse, pjesë e të cilave janë rezervat rregulluese automatike dhe manuale, e për të cilat KOSTT SH.A., ka dështuar ti përmbush detyrimet e tilla duke vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore.

ZRRE vlerëson se sqarimet e dhëna nga KOSTT në lidhje me Fondin e BRE-ve, janë të qarta dhe mjaft mirë të argumentuara edhe me tabela financiare, ku mes tjerash KOSTT me përgjegjësi deklaroi se asnjëherë nuk ka përdorur mjetet e Fondit të BRE-ve për mbulimin e humbjeve në katër komunitat veriore të Kosovës dhe se që nga 1 dhjetori 2017, konsumatorët e Kosovës asnjëherë nuk kanë paguar për humbjet në komunitat veriore të Kosovës përmes tarifave të KOSTT, dhe për këtë arsye edhe ia falë besimin gjatë shqyrtimit në lidhje me këtë shkelje.

Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2023 pas shqyrtimit të përgjigjeve/komenteve të dërguara nga „KOSTT“ SH.A, ndaj Raportit të Monitorimit për në lidhje me blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet për Operatorin e Sistemit të Transmetimit („KOSTT“ SH.A), ka konstatuar se: i) KOSTT SH.A., duke mos-vepruar me kohë në zbatimin e dispozitave përmbartimore sipas kontratës mes palëve, ka shkaktuar probleme financiare dhe ka rrezikuar stabilitetin financiar të KOSTT SH.A., e cila si kompani publike do duhej të reagojë me kohë; ii) KOSTT SH.A., nuk ka zbatuar garancionin financiar, duke vepruar në pa-pajtueshmëri me Nenin 8 të Rregullave të Tregut dhe me Procedurën e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar; iii) KOSTT SH.A., nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Nenin 28, par.1 dhe par. 2 dhe Nenin 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Nenin 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, dispozitat e Nenin 2 par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut dhe Nenin 8 par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike; iv) KOSTT SH.A., tregtimin e energjisë elektrike me KEK SH.A., për energjinë e pa-faturuar për pjesën veriore të Kosovës e ka bërë në shkelje të Nenin 22 par. 2 dhe 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike; v) KOSTT SH.A., ka vepruar në shkelje të Nenin 9 të Kontratës për Shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës e lidhur me KESH si Palë Ofruese e Shërbimit (POSH), duke ndikuar në kostot e operimit të KOSTT SH.A., e rrjedhimisht edhe të konsumatorët fundor, pasi që një kosto e tillë e mFRR, është kosto që njihet me aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale të KOSTT SH.A. konform Nenit 12 të Rregullës për të Hyrat e OST/OT-së; dhe vi) KOSTT SH.A., me aktivizimin e mFRR për nevoja të balancimit të sistemit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore të Nenit 13 par. 2 të Rregullës për të Hyrat e OST/OT-së.

Bordi i ZRRE-së, bazuar në ato më lartë ka vërtetuar se në asnjë rast dhe me asnjë fakt qoftë formal apo material KOSTT sh.a., nuk ka mundur të kundërshtoj/argumentoj të gjeturat përmes Raportit të Monitorimit lidhur me blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet për Operatorin e Sistemit të Transmetimit KOSTT, përjashtimisht për Fondin e BRE-ve, andaj ka nxjerr Njoftim lidhur me shkeljet e konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet nga Operatorin e Sistemit të Transmetimit („KOSTT“ SH.A.).

ZRRE në përputhje me dispozitat e Nenit 57 paragrafi 7 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Njoftimi i cekur më lartë i është dërguar me datë 24.02.2023 „KOSTT SH.A. në mënyrë që tu mundësohet përgjigja me shkrim lidhur me shkeljet e bëra, brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh nga pranimi i këtij njoftimi.

ZRRE me datë 13.03.2023 nga „KOSTT“ SH.A. ka pranuar përgjigjet me shkrim, në lidhje me shkeljet e konstatuara me Njoftimin e cekur më lartë, ku janë paraqitur në formë të shkruar arsyetimet në lidhje



shkeljet e konstatuara nga ZRRE, si dhe arsytetime tjera jashtë atyre të konstatuara përmes Njoftimit të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE, në mbledhjen e mbajtur me datë 05.05.2023, ka bërë vlerësimin dhe analizimin e përgjigjeve të paraqitura ndaj Njoftimit nga „KOSTT” SH.A, ka ardhur në përfundim se përgjigjet e “KOSTT” SH.A., nuk i kontestojnë me asnjë argument qoftë formal apo material shkeljet e konstatuara edhe përmes Njoftimit dhe evidentuara nga ana e ZRRE-së, mirëpo për shkak të vlerësimit dhe eliminimit të çfarëdo paqartësie, i kemi trajtuar me shumë kujdes dhe në përkujdesje të respektimit të legjislacion në fuqi.

Bordi ZRRE-së, me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi, ka vlerësuar drejt këtë çështje procedurale në rastin e shqiptimit të gjobës, për faktin se në kuadër të përgjegjësisë ZRRE, ka zhvilluar monitorim të bazuar në ligj, Procedurën për Tregtimin e Energjisë dhe Licencën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit KOSTT SH.A., Rregullat e Tregut dhe Kodin e Balancës dhe Kontratën për Shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës andaj, për të arritur te gjendja materiale ka vërtetuar drejt gjendjen faktike, dhe pas vërtetimit të drejtë të kësaj çështje në lidhje me veprimet e të Licencuarit, pretendimet e “KOSTT” SH.A. janë vlerësuar si të pa bazuara.

Bordi i ZRRE-së, po ashtu ka trajtuar edhe me shumë kujdes edhe çështjet tjera të cekura në përgjigjet e “KOSTT” SH.A., të cilat nuk janë relevante, pasi që konstatimet e vërtetuara nga ZRRE në asnjë rast dhe me asnjë fakt nuk ka mundur të kundërshtoi/argumentoj të gjeturat përmes Raportit të Monitorimit, por i njëjti vetëm ka bërë një përshkrim dhe vlerësime, dhe më këtë rast i njëjti ka vepruar në kundërshtim të plotë me obligimet e Licencës dhe obligimin e nxjerra nga Bordi i ZRRE-së, dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe ndarjen në kiste në periudhën 2 (dy) vjeçare, i ka marr parasysh edhe rrethanat lehtësuese duke pasuar parasysh sjellën paraprake, situatën financiare të të licencuarit të ndikuar edhe nga pandemia me COVID 19, si dhe rrethanat që kanë ndikuar nga situata financiare energjetike si dhe veprimet e të licencuarit të përmendura më lartë. ZRRE gjithashtu ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese edhe sjelljen dhe bashkëpunimin e “KOSTT” SH.A., me ZRRE-në, gjatë tërë këtij procesi.

Bordi i ZRRE-së, po ashtu me rastin e shqiptimit të gjobës ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, për faktin se qëllimi i këtij dënimi nuk është dëmtimi i ndërmarrjes, por përmirësimi i saj, që në veprimet e ardhshme në të mirë të sigurisë juridike të vetë të Licencuarit që të respektohen kushtet e Licencës dhe kërkesat ligjore të obligueshme në fuqi dhe të zbatueshme.

Bordi i ZRRE-së, për sa i përket shumës së gjobës si në dispozitivin nën pikën I. të këtij Vendimi, ka marr parasysh shkeljet e konstatuara, dhe në mënyrë komulative të të gjitha shkeljeve është propozuar gjoba bazuar në të hyrat që ndërmarrja ka akumuluar gjatë vitit fiskal paraprak, e që janë të bazuara në Raportin e Auditorit të Pavarur për Pasqyrat Financiare për Qëllime Specifike të Rregullatorit për vitin 2021 të KOSTT SH.A. dhe të dërguara në ZRRE.

Vendimi mbi shqiptimin e gjobës është marr konform dispozitave ligjore të Nenit 57 paragrafi 2 nënpar. 2.2, 2.7, 2.8 dhe 2.14 lidhur me par. 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe dispozitat e Nenit 2



nënp. 1.2 1.7, 1.8 dhe 1.14 lidhur me par. 2 dhe 4 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat, të nxjerr nga ZRRE.

Vendimi për pagesën e gjobës është marr konform dispozitave ligjore të Nenit 57 paragrafi 9 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Ymer Pejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Arkivit të ZRRE-së.